

## **RAPORT**

### **I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit Bsc Shkenca ekonomike me profile:**

- Financë, bankë dhe kontabilitet
- Administrim biznesi
- Biznes dhe ligj

**Ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Dorian MATRAKU**

**Prof. Asoc. Dr. Etleva BAJRAMI**

**(Korrik / 2018)**

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### **Për Programin e studimit Bsc Shkenca ekonomike me profile:**

- Financë, bankë dhe kontabilitet
- Administrim biznesi
- Biznes dhe ligj

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhër i riorganizimit	VKM Nr.177, date 19.02.2009 Urdhër Nr. 383, date 05.08.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 124, date 29.03.2012*
5	Titulli i programit të studimit:	Bsc në Shkenca ekonomike profile: • Financë, bankë dhe kontabilitet • Administrim biznesi • Biznes dhe ligj
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve për këtë program studimi	1971**

\*Ka një pasaktësi të emërtimit të programit të studimit në urdhërin e akreditimit të parë konkretisht: Bsc në “Ekonomi” me profile: Financë-bankë dhe kontabilitet; Administrim biznesi; Biznes dhe ligj.

Emërtimi i programit në raport është mbështetur në urdhërin e riorganizimit të programit dhe urdhërin për regjistrimin e formës së diplomave.

\*\*Ky numër studentësh i përket vitit aktual 2017-2018(viti I, viti II. dhe viti III)

### **Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

## HYRJE

**Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Shkenca ekonomike” me profile: “Financë, bankë dhe kontabilitet”, “Administrim biznesi”, “Biznes dhe ligj”.**

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka filluar aktivitetin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” është akredituar institucionalisht me urdhër Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.

Me Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011, mbështetur në VKA Nr. 198 dt. 24.06.2011, “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” ka riorganizuar programet e saj të studimit. Me Urdhër të Ministrit Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në VKA nr.303 dt 13.01.2012, Institucioni është akredituar institucionalisht dhe në programet Bachelor. Me Urdhër të Ministrit Nr 278 dt 19.05.2017, “*MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT “MESDHETAR I SHQIPËRISË”*” institucioni funksionon si Universitet. Që nga ky moment universiteti është i përbërë nga tre fakultete ndër të cilët dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike që ofron programin e studimit Bsc në “Shkenca ekonomike” me profile; “Financë, bankë dhe kontabilitet”, “Administrim biznesi”, “Biznes dhe ligj”.

Ky program studimi është licensuar me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 si “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në Ekonomi. Me Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011, mbështetur në VKA Nr. 198 dt. 24.06.2011 ky program studimi është riorganizuar nga DNP në Bsc në “Shkenca ekonomike” me profile; Financë, bankë dhe kontabilitet, Administrim biznesi, Biznes dhe ligj. Me Urdhër të Ministrit Nr. 124 dt. 29.03.2012, ky program studimi është akredituar si: Bsc në: “Ekonomi” *me profile: Financë,-bankë dhe kontabilitet, Administrim biznesi, Biznes dhe ligj.* Me anë të shkresës së MAS me nr .5503/1 prot, datë 03.10.2012, “Për regjistrimin e formave të diplomave” emërtimi i programit është Bsc në “Shkenca ekonomike” *me profile: Financë, bankë dhe kontabilitet, Administrim biznesi, Biznes dhe ligj.*

Ky program i nënshtrohet procesit të riakreditimit. Në vitin aktual 2017-2018 në këtë program studiojnë gjithsej 315 studentë në profilin Administrim Biznes, ndër të cilët 116 të regjistruar për herë të parë ndërsa të tjerët janë transferuar nga IAL të tjera.

Në profilin Financë-Bankë-Kontabilitet për këtë vit akademik janë të regjistruar për herë të parë 49 studentë dhe 110 të transferuar.

Në profilin Biznes dhe Ligj në këtë vit akademik ka të regjistruar 9 studentë për herë të parë dhe 2 studentë të transferuar.

Për viti akademik 2016-2017 kemi këto të dhëna:



1. Administrim Biznes total 250 studentë nga të cilët 120 studentë të regjistruar për herë të parë,
2. Financë, bankë dhe kontabilitet total 101 studentë ndër të cilët 49 të regjistruar për herë të parë,
3. Biznes dhe ligj në total 36 studentë nga të cilët 12 të regjistruar për herë të parë. Më shumë informacion për studentët e regjistruar në këtë program dhe ecurinë e tyre gjenden në pikën 9. Studentet, të këtij raporti.

Raporti i vlerësimit të jashtëm, mbështetet në shqyrtimin e dokumentave të mëposhtme si:

- Shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të UMSH në të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e zhvillimit të programeve mësimore (rregullore dhe udhëzime, vendime, dosjet e programeve të studimit, regjistrat themeltar, dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, sekretaria mësimore).
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës dy ditore në vend si dhe në intervistimet e studentëve, stafit akademik efektiv dhe me kontratë, stafit administrativ ndihmës, takimet me drejtuesit e institucionit si dhe vizitave në zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e NJSBC, zyrën e kurrikulave, bibliotekë, laborator, etj.

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, drejtuesit e njësive bazë, si dhe stafin akademik të këtij fakulteti të përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi, studentë, punonjësit e sekretarisë mësimore, të zyrës së bibliotekës, të burimeve njerëzore, të NJSBC, të kurrikulave. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij intitucioni, në bibliotekën e fakultetit, sallën e kompjuterave, sallat e leksioneve apo të seminareve. Mësimi zhvillohej në mjedise bashkohore ku sallat ishin të pajisura me mjetet e nevojshme si projektor dhe kompjuter. Stafi i angazhuar në mbulimin e këtij program studimi, ishte i pranishëm gjatë vizitës sonë. Vlerësimi i programit të studimit u përqëndrua në analizën e programit të studimit, objektivave formuese, kompetencat që fitohen, përputhshmëria e titullit të lëshuar me kurrikulën e ofruar, mënyrën e organizimit të kurrikulës, analizat e syllabuseve (programet e lëndëve), format e veprimtarive formuese për çdo disiplinë, mënyra e organizimit të vlerësimit të dijeve, kompetenca e stafit, literatura e përdorur etj. *Programi përgatit specialistë të ekonomisë në tre profile.* Gjithashtu, në përfundim të këtij programi studimi, studentët mund të ndjekin programe të studimit të Ciklit të dytë, Master Profesional apo Master Shkencor në fushën Ekonomike. Në këtë program studimi mund të regjistrohen personat që kanë mbaruar një Shkollë të Mesme, të përgjithshme ose profesionale, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në Fuqi.



## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr. Doriana MATRAKU
2. Prof. Asoc. Dr. Etleva BAJRAMI

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Më datë 19.06.2018 përmes sistemit Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. UMSH përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me nr. 301/6 prot, datë 26.06.2018 Objeksione për Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bsc në Shkenca Ekonomike me profile. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes komentet e institucionit reflektoi ndryshime në raportin përfundimtar për pikat 3, 4 dhe 5 të objeksioneve, pika të cilat nuk ndikojnë në konkluzionet e raportit të vlerësimit. Për objeksionet e tjera grupi i vlerësimit të jashtëm nuk reflektoi ndryshime në raportin përfundimtar.

## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- a) Të përfshihet në planin mësimor edhe një lëndë me zgjedhje për vitin e parë dhe të dytë, për profilet Financë, Bankë dhe kontabilitet; Administrim biznes.
- b) Të shikohet mundësia që për profilet: Financë, Bankë dhe Kontabilitet; Administrim biznesi, në vitin e tretë të studimeve, të shtohen disiplina sic janë “Kontrolli i brendshëm” dhe “Auditim në shërbimet e sigurisë”.
- c) Për profilin Biznes dhe ligj të shikohet mundësia për të zgjeruar disi më tej aspektin e trajtimit të ligjeve e rregullave duke përfshirë në mënyrë më të zgjeruar, çështjet e falimentimit, legjislacionin në funksionimin e entiteteve në industritë e rregulluara, me përfshirjen e këtyre tematikave në studimet e ciklit të dytë.
- d) Të parashikohen plane zhvillimi në mënyrë që të përballohet konkurrenca në rritje e tregut privat të arsimit të lartë.

### **II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- a) Për rekomandimin e parë institucioni ka bërë rishikim të programeve dhe është konsideruar se programi i studimeve Bsc në Shkenca Ekonomike me profile përfshin lëndë me zgjedhje të veprimtarisë (A-F) në vitin e dytë dhe të tretë. Studentët mund të zgjedhin lëndë të tjera



ekstrakurrikulare të cilat përfshihen dhe në Supplementin e Diplomës. Institucioni nuk e ka parë të nevojshme të ndryshojë programin mësimor. **Ky rekomandim nuk është plotësuar.**

- b) Për rekomandimin e dytë, institucioni nuk ka bërë ndryshime duke shpjeguar se tema të këtyre moduleve përfshihen në modulet egzistuese. Këto tematika sipas institucionit përfshihen në ciklin e dytë të studimeve. **Ky rekomandim nuk është plotësuar.**
- c) Për rekomandimin e tretë, institucioni ka rishikuar planin mësimor por pa bërë ndryshime në të. Për këtë program studimi është ndërhyrë në përmirësimin e syllabuseve egzistuese. Studentët zhvillojnë veprimtari ekstrakurrikulare si psh Acquis Communitare, që ju jep njohuri mbi legjislacionin dhe institucionet në nivel ndërkombëtar të BE. **Ky rekomandim është plotësuar.**
- d) Për rekomandimin e katërt, institucioni ka hartuar strategjinë e zhvillimit të tij dhe të programit Bsc. Janë përcaktuar objektivat, mundësitë e tregut të punës për studentët mbështetur në Ligjin 80/2015 dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë”. **Ky rekomandim është plotësuar .**

## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka filluar aktivitetin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” është akredituar institucionalisht me Urdhër Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.

Ky program studimi është licensuar me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 si “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në Ekonomi. Me Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011, mbështetur në VKA Nr. 198 dt. 24.06.2011 ky program studimi është riorganizuar nga DNP në Bsc në “Shkenca ekonomike” me profile; Financë, bankë dhe kontabilitet, Administrim biznesi, Biznes dhe ligj. Me Urdhër të Ministrit Nr. 124 dt. 29.03.2012, ky program studimi është akredituar si: Bsc në: “Ekonomi” *me profile:* Financë,-bankë dhe kontabilitet, Administrim biznesi, Biznes dhe ligj.

Misioni kryesor i insitucionit është të krijojë, zhvillojë dhe të përhap në një bazë të gjerë dijet e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në përshtatje me zhvillimet shoqërore, ekonomike në vend.

Misioni i programit të studimit është përgatitja e specialistëve në fushën e financës, bankë- dhe kontabilitet, specialist në marketing e menaxhim si dhe në profilin Biznes dhe ligj. Me njohuritë e përvetësuar studentët arrijnë të njohin mirë teorinë e kohës, veçanërisht drejtimin e ekonomisë, duke u thelluar në gërshetimin e kulturës profesionale të menaxhimit, me atë financiare, bankare dhe ligje, të gjitha këto në përputhje me kërkesat e tregut aktual të punës dhe në një afat kohor afatmesëm. Institucioni shpreson të luajë një rol të rëndësishëm për përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të një kurikule shumë disiplinore, e cila frymëzon dhe ushqen mënyrën e të menduarit kritik, përthith shpejt metodat e reja në mësimdhënie dhe inkurajon krijimtarinë, nëpërmjet integritit të teorisë në shkencën e ekonomisë si dhe gërshetimin e saj me shkencat e tjera. Me përgatitjen që ofron kurrikula e Fakultetit, kontribuon në aftësimin dhe perfeksionimin e studentëve si dhe përgatitjen e tyre për të përballuar problemet aktuale të karakterit të ngushtë profesional dhe me gjerë. Ky proces njëherazi ndikon në frymëzimin e mendimit krijues, duke motivuar studentët vazhdimisht për krijimin e ideve të reja që i përkasin brezave të ardhshëm.

### Qëllimi i programit

Programi “ **Bachelor në Shkenca Ekonomie** ” me profile, pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike, ka si objektiv kryesor:


- Të japë parimet bazë të teorisë të ekonomisë;
- të zhvillojë parimet e financës, biznesit dhe ligjeve;
- të përcaktojë modelet dhe mjetet e analizës për të përballur me sens kritik çështje që lidhen me funksionimin e ekonomisë.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni si dhe verifikimi gjatë vizitës në vend emërtimi i Diplomës së këtij program studimi është Bachelor në “Ekonomi” me profile, ndërsa, suplementi i diplomës është Bachelor në Shkenca Ekonomike, mendojmë se duhet të unifikohen Diploma me Suplementin.*


### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.



<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Shkenca ekonomike me profile është hartuar në përputhje me vullnetin e universitetit për të ndihmuar në ruajtjen e vlerave të komunitetit. Ky program studimi synon të ofrojë një tërësi njohurish dhe konceptesh teorike si dhe të aftësojë studentët në përdorimin e tyre praktik.</p> <p>Programi Bsc me profile është hartuar bazuar në strategjinë e Institucionit dhe synon përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të universitetit.</p> <p>Nga vizita në institucion u vu re se hartimi i programit të studimit Bsc në Shkenca ekonomike me profile, është ndërtuar me synim aftësimin e studentëve me njohuri, dhe kompetenca profesionale për të qenë të aftë dhe të suksesshëm në tregun e punës. Ky program formon specialistë në fushën e Financë-Kontabilitet-Bankë, Administrim Biznes dhe Biznes dhe Ligje.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Programi ka si objektiv për të edukuar, për të zgjeruar njohuritë e studentëve rreth fushës sipas etikës profesionale dhe për t'i përgatitur ata me eksperiencë për të ushtruar këtë profesion.</p> <p>Institucioni ka paraqitur një studim tregu. <i>Studimi i tregut ka një sërë mangësish dhe nuk mund të konsiderohet i kompletuar për sa i përket analizave të bëra dhe rezultateve të nxjerra.</i> Institucioni nuk ka studiuar nevojat e tregut për këtë kontigjent të arsimuar studentësh duke ditur që numri i të diplomuarve në programe të ngjashme është i madh. Institucioni ka bërë vetëm një hulumtim mbi disa burime informacioni.</p> <p>Ky program është hartuar duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik të vendit. Të diplomuarit në Bsc. Shkenca ekonomike kanë si opsion ndjekjen e programit të ciklit të dytë të studimit. Njohuritë e marra në këtë program janë të përgjithshme duke i dhënë mundësinë studentëve për një shumëllojshmëri programesh të ciklit të dytë.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e</p>	<p>Ky program studimi ofrohet përmes një kurrikule të strukturuar, e cila reflekton në një formë të balancuar njohuritë ekonomike. Institucioni nuk ka të detajuara planet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të programit të studimit Bsc.</p> <p>Bazuar në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimin e lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor me</p>





<p>specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>profile, programi i studimit të ciklit të parë pajis studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme.</p> <p>Bazuar në Kartën e Bolonjës, kurrikula e programit Bachelor me profile, pajis studentët me një llojshmëri të gjërë njohurish profesionale në funksion të realizimit të misionit dhe qëllimit të institucionit.</p> <p>Përmbajtja e programit, tekstet bazë dhe ato referenciale, përfaqësojnë një kombinim i cili synon të përgatisë një staf të aftë për të kryer me sukses operacionet ekonomike duke u përqëndruar në këtë program studimi. Ky program ofrohet përmes një kurrikule të strukturuar, e cila nuk ka pësuar ndryshime që nga viti i parë i hapjes së programit, dhe mendojmë se mund të bëhen disa axhustime me sa lejon ligji, për të përmirësuar dhe përditësuar kurrikulën me kurrikulat ndërkombëtare.</p> <p>Programi studimit është hartuar konform Ligjit nr. Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Udhezimit nr.15, date 04.04.2008 të MASH-se “Për organizimin e studimeve në IAL”, si dhe në përputhje me kriteret e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në 3 vite akademike dhe ofron në total 180 ECTS. Programi është hartuar në mënyrë të tillë që të plotësojë nevojat e studentëve, të shmangë mbivendosjet midis tyre në programet e studimit në vazhdimësi sidomos në programet e ciklit të dytë Msc.</p>
---	--

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Nga vizita në institucion, na u vu në dispozicion plani strategjik i UMSH. Një ndër objektivat në planin strategjik të institucionit është përditësimi i programeve mësimore sipas nevojave të tregut. Për të realizuar këtë proces merren konsulta nga eksperte, të cilët orientojnë kurrikulat sipas tregut të punës.</p> <p>Nga takimet e zhvilluara u vu re se institucioni ka zhvilluar një studim tregu por jo specifik për këtë program studimi. Institucioni sikurse edhe e theksuam nuk ka një studim të mirëfilltë tregu në përputhje me këtë program studimi. Studimi tregu nuk mbështetet në analiza apo konkluzione përsa i përket nevojave për këta të diplomuar. GVI sygjerojmë një studim afatmesëm 3-4 vjeçar me konkluzione përkatëse për të diplomuarit e këtij program sipas profileve.</p> <p>Cdo ndryshim në përcaktimin e kuotave të pranimit të studentëve, duhet të bazohet në konkluzionet e studimit të tregut.</p>
---	---

**Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.**

**Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Program i studimit është hartuar në përputhje me vullnetin e universitetit për të ndihmuar në ruajtjen e vlerave të komunitetit.

Programi i studimit nuk bie ndesh me vlerat kulturore kombëtare, përkundrazi ai i promovon ato nëpërmjet promovimit të elementëve të etikës.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Programi studimit është hartuar konform Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Programi i studimit është i organizuar në 3 vite akademike dhe ofron në total 180 ECTS. Ky program studimi përgatit specialistë të lartë në fushën e shkencave ekonomike në tre profile.
3. Institucioni ka përgatitur strategji institucionale dhe për programin e studimit, ka bërë një studim tregu. Institucioni nuk ka bërë asnjë ndryshim në kurrikul që nga momenti i hapjes së programit të studimit mgjse tregu ka ndryshuar, konkurenca është rritur, dhe Ligji i arsimit të lartë ka ndryshuar.
4. Institucioni duhet të detajoj` strategjitë afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata për arritjen e objektivave në mbarëvajtjen e suksesshme të këtij programi studimi.

**Standarti plotësohet pjesërisht.**

**2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura organizative e UMSH është e përcaktuar në Statutin e tij, në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Struktura akademike përgjegjëse për programin e studimit Bsc në Shkenca ekonomike, është Fakulteti i Shkencave Ekonomike, me tre departamente:

1. Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet.
2. Departamenti i Ekonomisë.
3. Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor.

Sipas Vendimit të Senatit Nr.6/1, datë 19.05.2017, programi konfirmohet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, ku profili Financë, bankë dhe kontabilitet ofrohet nga Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet; kurse profilet Administrim biznes dhe Biznes dhe ligj ofrohen nga Departamenti i Ekonomisë.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike përbëhet nga tre Departamente dhe për vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij;

Departamenti i Ekonomisë ka gjithsej 18 pedagogë nga të cilët 13 janë personel akademik efektiv (PAE), kurse 5 pedagogë janë personel akademik me kontratë (PAK).

Departamenti i FBK ka gjithsej 21 pedagogë, nga të cilët 12 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 9 personel akademik me kontratë (PAK).

Departamenti IF ka gjithsej 20 pedagogë nga të cilët 14 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 6 pedagogë janë personel akademik me kontratë (PAK). Në total Fakulteti Shkencave Ekonomike përbëhet nga 59 pedagogë. Personeli administrativ në funksion të Fakultetit përbëhet nga anëtarë të cilët kryejnë disa funksione në institucion. Fakulteti drejtohet nga Dekani i cili emërohet nga Rektori.

Organet Drejtuese të Universitetit janë:

- Rektori - Aktualisht Rektor është Prof. Dr. Nexhmi Dumani.
- Senati Akademik - Organ kolegjal. Shqyrton problematikat më të rëndësishme të institucionit në fushën didaktike, kërkimit shkencor, administrativ. Ka 8 anëtarë. Anëtarët e senatit mbajnë tituj ose grada shkencore: 1 me gradën Dr, 6 anëtarë kanë titullin shkencor Prof. Asoc. Dr., 1 anëtar është Prof. Dr.
- Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike është Prof. Asoc. Dr. Alqi Naqellari.
- Bordi administrimit- Eros Angjeli kryetar dhe 5 anëtarë.
- Tre Fakultete me nga tre Departamente secili. Cdo departament ka Përgjegjës për njësinë bazë.

Programi i studimit Bsc në Shkenca ekonomike me Profile, ofrohet nga departamenti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Bankë-Kontabilitet.

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.



Departamentet përgjegjëse për programin e studimit Bsc në Shkenca ekonomike me profile janë Departamenti i Financë-Bankë-Kontabilitet dhe Departamenti i Ekonomisë. Personeli akademik dhe drejtuesit akademik të Departamentit Financë- Bankë- Kontabilitet dhe Departamentit të Ekonomisë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative. Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. **(Aneksi 1 Tabela 1.)**

Stafi akademik efektiv dhe me kontratë për departamentet përgjegjëse të programit të studimit Bsc Shkenca ekonomike jepet në **(Aneksin 1, Tabela 2 dhe 3).**

Institucioni ka paraqitur në Dosjen e Vetvleresimit tabelat me stafin e angazhuar në programin e studimit, që nga viti akademik 2012-2013. Konkretisht:

Për vitin akademik **2012-2013** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **21** pedagogë gjithsej, nga te cilet **9** kanë qenë PAE, **2** me tituj/grada dhe **12** PAK **8** me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është **43%/57%**.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **22** pedagogë gjithsej, nga te cilet **9** kanë qenë PAE, **5** me tituj/grada dhe **13** PAK, **11** me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është **41%/59%**.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **27** pedagogë gjithsej, nga te cilet **17** kanë qenë PAE, **9** me tituj/grada dhe **10** PAK, **8** me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është **63%/37%**.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **32** pedagogë gjithsej, nga te cilet **20** kanë qenë PAE, **12** me tituj/grada dhe **12** PAK, **11** me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është **62%/38%**.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **30** pedagogë gjithsej, nga te cilet **22** kanë qenë PAE, **12** me tituj/grada dhe **8** PAK, **7** me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është **73%/27%**.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **42** pedagogë gjithsej, nga te cilet **34** janë PAE, **17** me tituj/grada dhe **8** PAK, **7** me tituj/grada. Pra raporti PAE/PAK është **81%/19%**.



**(Tabela 5, Aneksi 2)**

Në Aneksin 2 Tabela 6 jepen të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për vitin akademik 2017-2018

Shikohet qartë një shtim i numrit të pedagogëve efektiv të përfshirë në programin e studimit.

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program per vitin akademik aktual është 42/1971 ose 1 pedagog për afërsisht 47 studentë, ndërsa për vitin akademik 2016-2017 është 30/1700 ose 1 pedagog për 56 studentë. Për vitin akademik 2015-2016 ky raport rezulton 1 pedagog për 39 studentë ose 32/1234. Vihet re se numri I pedagogëve eshte rritur por numri I studentëve është rritur disa herë më shumë dhe kjo ka bërë që raporti personel akademik/student të përkeqësohet.

Raporti Personel Administrativ / Student në këtë program per vitin akademik aktual është 0/0= 0. Nuk kemi informacion mbi personelin administrativ, pasi një pjese e stafit akademik është i përfshirë në detyra administrative.

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është 34/8 =4,25 ndersa per vitin akademik 2016-2017 eshte 22/8 =2,75.

Raporti pedagogeve të përfshirë në zhvillimin e këtij programi/student për vitin akademik aktual është 1 pedagog për 3 studentë të regjistruar, ndersa per vitin akademik 2016-2017 eshte 1 pedagog për 4 studentë të regjistruar.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre **(Tabela 5,6, Aneksi 2)**
- Të dhënat sipas moshës së personelit jepen **(Tabela 7 në Aneks 2)**
- Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2017-2018, në programin e studimit janë përfshirë 41% meshkuj dhe 59% femra, në vitin akademik 2016-2017, 48% meshkuj dhe 52% femra.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit sipas RVB dhe verifikimit të viiztës në institucion përbëhet nga tre anëtarë.

**Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit**

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Gudar Beqiraj	Akademik	Kryetar
Greta Angjeli	Profesor	Anëtar



Altin Hoti	Profesor	Anëtar
------------	----------	--------

**☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Çdo anëtar i stafit akademik dhe administrativ nënshkruan kontratën e punës me UMSH, ku përcaktohen të gjitha detyrimet dhe të drejtat e palëve. Universiteti Mesdhetar ka një strukturë të posaçme të emërtuar. Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës. Kjo zyrë ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhënave etj. Stafit akademik lidh me institucionin kontrata të rregullta punësimi me kohë të plotë ose pjesëtime, të cilat hartohen dhe depozitohen pranë zyrës së Burimeve Njerëzore. Përzgjedhja e stafit akademik bëhet nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent. Pas shpalljes së Vendeve të lira të Punës në web-sitin e institucionit, bëhet dhe selektimi dhe seleksionimi nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo e fundit merret me procedurën e parashikuar, për ngritjen e komisionit përkatës të përzgjedhjes së kandidatëve, në përputhje të plotë me rregulloren e IAL. Përzgjedhja e pedagogëve me kontratë bëhet nga një komisioni i ngritur ad hoc, në përbërje të të cilit është Dekani i Fakultetit, Profesorët titullarët të lëndëve përkatëse. Në zyrën e Burimeve Njerëzore u kërkuan tre dosje në mënyrë të rastësishme.

*Dosja pedagogut përmban:*

- Kurrikulum Vitae të pedagogut;
- Fotokopje ID
- Fotokopje të noterizuara të diplomës së shkollës së lartë (jo në të gjitha rastet të noterizuara)
- Fotokopje të titujve (Postmaster, PHD);
- Fotokopje të panoterizuar të kualifikimeve të tjera (ne rast se ka)
- Kontrata

Në dosje nuk ishin dokumentat e mëposhtme:

- Librezë shëndetësore dhe raport mjekësor që vërteton që personi është i aftë për punë.

Nga vizita në institucion u vu re se i gjithë stafi është me kontratë e cila ka një afat 6 muaj (PAK) një vjeçar ose të pacaktuar për PAE.

Vihet re një përmirësim i stafit PAE në vitin e fundit sidomos me një brez të ri të përfshirë në proces doktore jashtë Shqipërisë. Stafit akademik PAK përbëhet nga pedagogë me grada dhe tituj shkencorë. Departamenti ndjek në mënyrë të vazhdueshme performancën e stafit akademik. Ka vlerësim nga studentët por edhe nga stafi: puna shkencore, tutoriati, udhëheqja e diplomave etj. Mesatarisht stafi akademik mbulon 2-3 module, ndërsa stafi akademik i përfshirë në proces doktore ka një ngarkesë më të vogël.



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni publikon në faqen e Web-it <a href="http://www.umsh.edu.al">www.umsh.edu.al</a> kriteret dhe nevojat e rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>UMSH i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Procedurat ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit.</p> <p>Në Fakultetin e Shkencave Ekonomike janë të punësuar <b>39</b> pedagogë me kohë të plotë dhe <b>20</b> pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën <b>81%</b> të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor.</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Sa i takon vlerësimit të performancës, pedagogët i nënshtrohen vlerësimit nga studentët dhe vlerësimit nga drejtuesit në fund të vitit akademik në lidhje me performancën, kërkimin shkencor, ngarkesën mësimore, tutoriatin.</p> <p>Institucioni mban baza të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit dhe të njoftimeve për punë. Në zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden dosjet e aplikantëve.</p> <p>Në vitin e parë të funksionimit të këtij programi, vetëm rreth 43 % e programit mbulohej nga pedagogë me kohë të plotë. Në vitin e fundit akademik vihet re një rritje e numrit të pedagogëve me kohë të plotë që mbulojnë këtë program. Ky raport ka shkuar tashmë në rreth <b>81 %</b>.</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore për vlerësimin e stafit. Mjeti më i përdorshëm për vlerësim janë pyetsorët e plotësuar nga studentët. Kjo u konfirmua dhe nga bisedat me studentët.</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mban të dhëna të hollësishme në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, ngarkesën që mbulon. Gjithashtu institucioni disponon një bazë të dhënash të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. GVJ bëri vizitë të</p>



<p>personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,</p>	<p>posacme në Zyrën e Burimeve Njerëzore</p> <p>Institucioni në fillim të vitit akademik publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti ku konkurron kandidati dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web të institucionit.</p> <p>Institucioni nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore, disponon një dosje të cdo pedagogu efektiv ose me kontratë. Nga vizita në vend u kontrolluan dosje me përzgjedhje rastësore të stafit akademik (PAE) dhe (PAK). Në dosje ndodheshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurrikulum Vitae të pedagogut;</li> <li>• Fotokopje ID</li> <li>• Fotokopje të noterizuara të diplomës së shkollës së lartë (jo në të gjitha rastet të noterizuara)</li> <li>• Fotokopje të noterizuara të titujve (Postmaster, PHD);</li> <li>• Fotokopje të panoterizuar të kualifikimeve të tjera (ne rast se ka)</li> </ul> <p>Në dosjet e vëzhguara mungonin dokumenta të tilla si;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fotokopje të librezes se kontributeve shoqërore dhe shëndetësore;</li> <li>• Librezë shëndetësore dhe raport mjekësor që vërteton që personi është i aftë për punë.</li> </ul> <p>Sipas institucionit k`to dokumenta ruhen n` zyr`n e financ`s. Zyra e burimeve njerëzore vuri në dispozicion listën e plotë të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Personeli administrativ është i përfshirë dhe si pedagog dhe është e vështirë të ndash vetëm stafin në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Procesi i rekrutimit kryhet nga një bashkepunim i Departamentit me zyrën e Burimeve Njerëzore nëpërmjet kriterëve dhe procedurave të përcaktuara. Njoftimet për rekrutimet bëhen në websiten e Institucionit.</p> <p>Institucioni nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për të mbuluar cdo lëndë/modul me titullar me tituj apo grada shkencore nga stafi efektiv.</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollë;</p>	<p>Në këtë program studimi janë parashikuar orë në laborator, cka është një dukuri e zakonshme për një fakultet ekonomie. Universiteti ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e këtyre orëve.</p>





<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p>	<p>UMSH ka angazhuar personel ndihmës mësimor–shkencor për realizimin e orëve laboratorike. Personeli administrativ dhe akademik është gjithmonë në shërbim të studentëve për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>UMSH dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>
	<p>UMSH ka vënë në dispozicion personel për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</p>
	<p>Institucioni ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm më ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Mbikëqyrja bëhet nga anëtarët e stafit akademik të cilët ndjekin zhvillimin korrekt të praktikës profesionale në institucionin pritës dhe japin vlerësimin e tyre në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit.</p>
	<p>Departamenti vendos pedagogë efektiv për ndjekjen e praktikave mësimore. Një pedagog ndjek afërsisht 8- 10 studentë në modulin e praktikës.</p>

**Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione vendase dhe të huaja, por që nuk janë shfrytëzuar për programe kualifikimi të stafit apo të studentëve. Stafi akademik që ndjek kualifikimin jashtë në kuadër të PhD, janë të aktivizuar në programe individualisht, megjithatë institucioni i ka krijuar kushtet e nevojshme për kualifikimin e tyre si psh. një ngarkesë më të reduktuar mësimore, përkrahje financiare për pjesëmarrje në konferenca, botime në revistën e institucionit etj.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>UMSH angazhohet maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij. Janë zhvilluar konferencave shkencore nga njësitë bazë. Institucioni nxit anëtarët e personelit të tij akademik të botojnë artikuj në Revisten Shkencore të institucionit.</p>

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Programi i studimit Bsc. me profile mbulohet nga Departamenti i Ekonomisë, i cili aktualisht përbëhet nga 13 pedagogë efektiv dhe 5 pedagogë me kontratë, si dhe departamenti i Financë Bankë Kontabilitet me një numër PAE 12 pedagogë dhe 9 PAK.
- Numri i pedagoqeve efektivë përbën 77% të personelit gjithsej të angazhuar në programin e studimit të nivelit të parë.
- Numri i pedagoqeve efektivë dhe ngarkesa mësimore që mbulohet prej tyre është rritur ndjeshëm.
- Institucioni ka personel akademik të përfshirë dhe në detyra administrative.
- Institucioni ka ende mangësi për pedagogë me tituj dhe grada shkencore. Shumica e stafit është ende në proces kualifikimi. Kështu 69% e stafit PAE në departamentin e Ekonomisë janë në proces doktrature ose me Msc. 57% e stafit PAE në departamentin FBK janë me Msc ose

proces doktrature.

- Institucioni rekruton staf akademik sipas nevojave të departamentit në përputhje me kriteret e përcaktuara. Institucioni nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për të mbuluar cdo lëndë/modul me titullar me tituj apo grada shkencore.

**Standarti përmbushet pjesërisht** sepse institucioni duhet të ketë më shumë prani të pedagogëve efektiv me grada dhe tituj shkencor në DEK dhe në DFBK. Përgjegjësit e departamenteve mbajnë titullin Dr.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit.**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

##### **Pjesa përshkrimore**

UMSH zhvillon aktivitetin në një godinë me një sip. 3860 m<sup>2</sup>. Programi i studimit Bsc. Shkenca Ekonomike zhvillon mësimin paradite nga e hëna në të premte, ndërsa institucioni zhvillon programet e tjera të studimit (sidomos ciklin e dytë) nga e hëna në të shtunë në orarin 8:00 deri 21:00.

Ambientet janë komode dhe të përshtatshme për një institucion arsimor dhe nuk përmbajnë elementë të rrezikshëm. Këto ambiente plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të nevojshme për të siguruar mbrojtjen efektive të shëndetit të studentëve dhe personelit. Materialet dhe teknologjia e punimeve sigurojnë akustikë të mirë në ambientet e mësimit dhe janë të izoluar ndaj zhurmave, luhatjeve të temperaturës dhe lagështirës. Sallat e pedagogëve, auditorët, koridoret, nyjet hidrosanitare, shkallët, etj. janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në pikën 6 të VKM Nr.38, datë 16.01.2003 “Për miratimin e normativave, të rregullave e kushteve të projektimit të ndërimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa”. Mjediset janë në gjendje të thatë dhe pa lagështi. Në godinën kryesore, janë të përqëndruara dhe biblioteka, salla e leximit, laboratore, ambiente clodhje bar etj. Godina e UMSH është e pozicionuar në një nga qendrat kryesore të kryeqytetit ku është lehtësisht e arritshme me transport publik, biciklete apo dhe në këmbë. Ambientet në total në dispozicion të fakultetit që mbulojnë programin e studimit janë: 6 salla leksioni, 15 seminari, salla për aktivitete promovuese, salla për pedagogët, sallë për konferenca, biblioteka etj. Konkretisht në këtë godinë janë të vendosur zyra e rektorit, dekanit, departamenti përgjegjës për këtë program studimi, zyra e burimeve njerëzore. Në godinë ndodhet dhe sekretaria mësimore.

Biblioteka pasurohet cdo vit me tituj të rinj. Ka një sallë që u vjen në ndihmë studentëve jo vetëm për studim, por edhe për fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare. Në këtë sallë, përdoruesve të bibliotekës u mundësohet jo vetëm akses në internet, por edhe përdorimi i disa kompjuterave (6 të tillë) për përgatitjen e detyrave të kursit, seminareve, kumtesave shkencore, punimeve kërkimore shkencore.

Biblioteka është pasuruar me tituj të rinj ku aktualisht ka rreth 4000 tituj për të gjithë programet e studimit. Biblioteka është pasuruar me një akses online në [www.uestia.com](http://www.uestia.com). Biblioteka ka një orar të përcaktuar nga ora 8.30 - 20.30.

Materialet bibliotekare janë regjistruar dhe përpunuar sipas kërkesave ligjore, IFLA (World Information and Information Congres) dhe Ligjit nr. 8576, datë 03.02.2006. “Për bibliotekat ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Koleksionet e bibliotekës, salla e leximit apo huazimi i materialeve janë vënë në shërbim të procesit mesimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore të UMSH-së. Është siguruar një ambient i bibliotekës me vende studimi, për studentët dhe stafin. Studentët janë në dijeni për librat që ata mund të studiojnë, huazojnë apo blejnë në bibliotekë. Është siguruar shërbim interneti falas për studentët dhe stafin e institucionit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione 6
- Klasa për seminare 15
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Laboratorë informatike 3
- Salla interneti 1
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyrë informacioni për studentët 1
- Nyje hidrosanitare 53

#### Mjediset për stafin:


- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 7
- Zyra për sekretarinë mësimore 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 8
- Zyra për personelin akademik 2

Institucioni ka dhënë detajet e mësipërme në RVB përsa i përket infrastrukturës. Nga vizita në institucion, GVJ vlerëson si shumë pozitive ambjentet e zhvillimit të procesit mësimor si dhe shumë komode, mjediset e përshtatura për stafin akademik dhe atë administrativ.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Biblioteka është pjesë e infrastrukturës së institucionit. Biblioteka ndodhet në të njëjtën godinë me sallat e leksionit apo seminareve. Hapësira e bibliotekës është e madhe dhe e mjaftueshme por nga bisedat me studentët, nuk frekuentohej shpesh nga ata.
<b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	UMSH ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik një numër tekstesh bazë dhe literature ndihmëse. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqes elektronike “questia”.
<b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të	

<p>cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka pasurohet çdo vit me tituj të rinj duke marrë në konsideratë kërkesat e pedagogëve për titujt që i vijnë në ndihmë studentëve për procesin mësimor.</p> <p>GVJ kërkoi një listë të titujve të botimeve që ndodheshin në bibliotekë listë e cila na u vendos në dispozicion.</p> <p>Biblioteka zotëronte tituj të librave që përdoren në këtë program studimi. <i>Titujt nuk ishin të mjaftueshëm për të gjithë studentët pjesëmarrës në këtë program studimi.</i></p> <p>Përsa i përket broshurave apo raporteve periodike si psh nga Banka e Shqipërisë, ato ishin të disa viteve më parë, dhe nuk kishte një marrëveshje institucionale për përditësimin e tyre.</p> <p><i>Mungonin studimet periodike shkencore në gjuhën shqipe, të cilat mund të përdoreshin si informacion ndihmës në procesin mësimor.</i></p> <p>Institucioni duhet të krijojë marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione që ofrojnë përpunim të të dhënave si psh me Bankën Qendrore, INSTAT, Ministria e Financave etj, sepse sigurimi i këtyre materialeve do ishte më i sigurtë dhe bashkëkohor.</p> <p>Institucioni ka një akses online i cili është i paraqitur dhe në faqen e web.</p> <p>Oraret e shërbimit të bibliotekës përputhen me oraret dhe nevojat e studentëve për këtë program studimi. Nga vizita në institucion u njoftua se orari i bibliotekës është 8.30-20.30</p> <p>Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit , përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të. Njësitë përcaktojnë titujt e nevojshëm për çdo program studimi dhe ia përcjellin rektoratit dhe më pas bibliotekës.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni ka në zotërim një ndërtesë të pajisur me salla leksionesh, seminaresh, konferencash, laboratorësh të informatikës të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Të gjitha ambientet që disponon UMSH, janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka laborator kompiuterash, të cilët përdoren gjatë procesit mësimor në lëndët që kanë si ngarkesë mësimore edhe laborator.</p> <p>Institucioni ka mjaftueshëm klasa seminaresh dhe</p>



<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>leksionesh të pajisur me projector dhe kompiutera. Praktikrat profesionale janë praktika që në rastin e programit të studimit bëhen pranë bizneseve të ndryshme, bankave, apo institucioneve shtetërore por dhe pranë institucionit.</p> <p>Për mësimin praktik në lëndë të veçanta janë në dispozicion dhe përdoren programe kompjuterike profesionale që sjellin në auditor situatat praktike (në Kontabilitet programet Alpha dhe Financa 5, për gjuhën e huaj në vitin e tretë është përfshirë gjuha angleze profesionale si lëndë ekstrakurrikulare). Këto programe profesionale prej disa vjetësh janë bërë pjesë e programeve të lëndëve përkatëse, si rezultat edhe i bashkëpunimit me kompani të specializuara, si IMB Institucioni ka mjaftueshëm klasa seminaresh dhe leksionesh të pajisura me mjetet përkatëse.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, por jo të gjitha garantojnë zhvillimin e praktikave profesionale.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucioni ka në administrim salla leksioni dhe seminaresh për një zhvillim normal të mësimdhënies për këtë program studimi.</li> <li>• Institucioni ka një laborator kompjuterash, një sallë biblioteke me numër të titujve në rritje nga viti në vit.</li> <li>• Personeli akademik dhe studentët kanë akses në shfrytëzimin online të faqes elektronike dhe në kompiuterat e sallës së leximit në biblioteke. Biblioteka funksionon me orar dhe ofron kushte të mira për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore.</li> <li>• Infrastruktura është e përshtatshme për një proces mësimor të rregullt.</li> </ul> <p><b>Standarti përmbushet plotësisht</b></p>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.


### Pjesa përshkrimore

UMSH është projekt i “Qendrës së Mesdheut”. Kjo OJF është regjistruar me Vendim Nr. 411 dt 06.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si person Juridik. Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjal Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i “Qendra e Mesdheut” emëron anëtarët e Bordit të Administrimit. Institucioni mbështetet në vetfinancim. Të ardhurat e tij formohen nga tarifat e studentëve dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit (sipas RVB)**

Të ardhurat nga:	2012	2013	2014	2015	2016	2017
------------------	------	------	------	------	------	------



Pushteti qendror						
Pushteti vendor						
Fonde jopublike:						
Grantet për kërkim dhe kontratat						1,599
Konsulencat, shërbimet						
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	92,166	105,083	130,786	194,030	237,208	293,645
Sponsorizimet						
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)						
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj						
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	1,166	739	2,180	720	9,510	3,362
<b>SHUMA</b>	<b>93,332</b>	<b>105,822</b>	<b>132,966</b>	<b>194,750</b>	<b>246,721</b>	<b>298,606</b>

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje (sipas RVB))**

Pasqyra dinamike e koston për student 2011-2017 ne 000/ leke									
Nr	Emertimi	Njësia	Vitet						Buxhet
			2011-2012	2012-2013	2013-2014	2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018
1	<b>Totali financimit</b>	Lekë	98,039	104,016	121,875	162,819	215,443	254,137	288,522
2	<b>Kostoja per student</b>	Lekë /student	257	172	178	102	100	106	137

Institucioni ka paraqitur në RVB vetëm dy tabela. Të ardhurat nga kuotat e studentëve dhe aktiviteti tregtar në periudhën 2012-2017 dhe koston për studentë të përlllogaritura për këto vite. Shikohet një rënie e kostove për student pra një përmirësim financiar dhe kjo për faktin se numri i studentëve në vitet e fundit është rritur. Në vitin akademik 2011-2012 kosto për student vlerësohej 257,000 lek ndërsa për vitin e fundit akademik kjo kosto është reduktuar në 137,000 lek.

Në vizitën në terren grupi i vlerësimit të jashtëm ka kërkuar një kopje të auditit. Kjo kopje është dorëzuar nga institucioni. Institucioni kryen auditime të rregullta. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njëësia e auditimit të brendshëm e Institucionit. Auditimi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi (neni 32, Rregullore Organizative UMSH).

Institucioni nuk ka të ardhura nga grantet përveçse në vitin 2017. Në vizitën në terren është dorëzuar një dokument ku pasqyron përfshirjen e UMSH në disa projekte të BE por deri tani janë akoma në fazë aplikimi.



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni kryen auditime të brendshme të vazhdueshme. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësi e auditimit të brendshëm e Institucionit. Auditimi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi (neni 32, Rregullore Organizative UMSH).</p> <p>Deri tani të ardhurat e institucionit nga projektet dhe grantet janë të limituara. Institucioni ka aplikuar në disa projekte, por në pasqyrat financiare nuk pasqyrohen të ardhura nga ky zë. Një pjesë e projekteve janë akoma në fazë aplikimi.</p> <p>Në mënyrë periodike, Bordi kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve duke e përvijuar në mënyrë eksplicite drejtimin e saj në rritjen e cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimin e stafit akademik (duke zhvilluar një sistem pagesash dhe rekrutimesh mbi baza cilësie). Në vizitën në institucion GVJ ka kërkuar një kopje të auditit e cila na është dorëzuar nga institucioni.</p> <p>Stafi akademik i kontaktuar nga vizita në institucion, janë shprehur se nuk kanë pasur asnjëherë probleme financiare me UMSH dhe është zbatuar regjorizisht kontrata e nënshkruar si në rastin e PAE ashtu dhe në rastet e PAK.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni nuk ka dorëzuar dokumenta të hollësishme rreth burimit të të ardhurave. Ka vetëm një tabelë ku jepen të ardhurat nga tarifat e studentëve në total dhe kjo jo e specifikuar për pagesat e secilit student, numrin e studentëve dhe nuk kuptohet nëse këto pagesa përfshijnë të gjithë studentët apo specifikisht vetëm këtë program.</p> <p>UMSH është projekt i OJF "Qendra Mesdheu" dhe në bazë të statutit harton raporte të përvitshme financiare të detajuara të cilat i paraqiten Bordit në çdo vit, duke siguruar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë financiare në gjenerimin e të ardhurave dhe vijueshmërisë së aktivitetit.</p> <p>Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit.</p>

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

- UMSH në përmbushje të kriterëve për transparencë dhe informim harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve, duke plotësuar të gjitha standartet normative, ligjore ose nënligjore.
- Institucioni ka dorëzuar në RVB vetëm tabelën e shpenzimeve dhe të ardhurave. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e studentëve dhe aktiviteti tregtar. Institucioni ka aplikuar në disa projekte në mënyrë që të sigurojë një burim tjetër të ardhurash.
- Institucioni duhet të jetë më transparent në materialet lidhur me pagesat e studentëve, detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative si dhe grante të huaja të përfituara nëse ka.
- Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është projekt i OJF “Qendra Mesdheu” dhe kjo i siguron një qëndrueshmëri financiare.

### **Standardet përmbushen plotësisht**

## **6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

### **Pjesa përshkimore**

Pranë Institucionit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave prej Janarit të vitit 2011. Kjo njësi përbëhet nga 7 anëtarë. Në fillimet e punës së vet është ngritur si Komision i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBCZHK duhet të planifikojë organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimit institucional. **(Tabela 8. Anëtarët e NJSBC)**

NJSBCZHK është organi kryesor që realizon anketimet për matjen e performancës së pedagogëve në procesin mësimor, për vlerësimin e infrastrukturës mësimore, për vlerësimin e punës me studentët dhe të sekretarisë mësimore. NJSBCZHK në bashkëpunim me rektoratin, dekanatin dhe Zyrën e burimeve njerëzore, realizon edhe pyetësin për vlerësimin e pedagogëve, me anë të metodës së vetvlerësimit. Pyetësi përmban të dhëna kryesisht për cilësinë e mësimdhënies, mënyrës së mësimdhënies, etj.

Raporti përfundimtar i NJSBCZHK përmban të dhëna edhe për raportin me studentët si dhe të dhëna për punën kërkimore shkencore, të cilat do të jenë pjesë e performancës së pedagogëve.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:





Anketimet për vlerësimin e performancës së pedagogëve bëhen përpara provimit përfundimtar në fund të çdo semestri. Nga vizita në institucion dhe takimet me stafin dhe studentët na u komunikua që pyetësorët për këtë anketë realizoheshin përpara provimit të lëndëve. Studentët theksuan se nëse ata hasnin ndonjë problematikë në ndonjë lëndë të caktuar, nuk prisnin fundin e semestrit por komunikonin me tutorin apo përgjegjësit e njësive bazë ku identifikonin problematikën dhe ju jepej zgjidhje shume shpejt. Studentët u shprehën të kënaqur në lidhje me reagimin e shpejtë të institucionit.

Studentët anketohen 2 herë në vit, përpara sezoneve të provimeve. Në këto anketa marrin pjesë studentët që janë prezent dhe dëshirojnë të anketohen, përgjithësisht 60% e studentëve aktivë për vitin akademik, sipas RVB.

Anketa përpunohet nga NJSBCZHK dhe përfundimet raportohen pranë dekanit dhe rektoratit. Në raport rekomandohen detyra të cilat do të ndiqen për zbatim nga strukturat drejtuese dhe nga NJSBCZHK.

#### **Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Në fokus të kontrollit të brendshëm të cilësisë janë: stafi akademik, stafi ndihmës mësimor shkencor, stafi joakademik, studentët dhe stafi administrativ.

UMSH ka hartuar Manual të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili është miratuar nga Rektori i Universitetit. NJSBCZHK në mënyrë periodike raporton dhe informon organet drejtuese në lidhje me rezultatet e kontrolleve të zhvilluara. Ky raportim bëhet në mënyrë konfidenciale për të gjithë stafin e UMSH.

#### **Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

Në nivel institucional përgjegjësinë për sigurimin e cilësisë së brendshme e ka Senati, i cili miraton planin strategjik. Rektori është përgjegjës për përpilimin e planveprimit të vetvlerësimit të cilësisë në nivel universiteti. NJSBCZHK operon sipas një plani kalendar të përvitshëm. Implementimi i planit të përcaktuar kryhet nga NJSBC dhe nga Grupet e vlerësimit të Brendshëm të cilësisë.

Në përbërje të NJSBC ka jo vetëm staf akademik por edhe studentë dhe anëtar të sekretarisë mësimore, duke bërë të mundur kështu njohjen me problematika të ndryshme.

Nga vizita në institucion na u komunikua se një formë e kontrollit të cilësisë ishte edhe asistimi në auditorë gjatë mësimit të profesorëve të lëndëve apo përgjegjësi i departamentit për të ndjekur nga afër mënyrën e mësimdhënies.

#### **Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

NJSBCZHK vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore– shkencore të Universitetit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një nga format më të përdorura për vlerësimin e cilësisë në UMSH është Pyetësori me studentët.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

NJSBCZHK harton një raport vjetor të punës së saj, i cili i paraqitet dekanëve dhe Rektoratit. Raportet e haruara nga NJSBCZHK përdoren si burim për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Në bazë të këtij raporti merren informacionet mbi nevojën për përmirësim të cilësisë. Sipas rregullores Rektorati bënë vlerësimin e punës së NJSBCZHK, aprovon raportin dhe miraton programin e punës për vitin pasardhës. NJSBCZHK ka hartuar raport deri për vitin akademik 2016-2017, meqënëse viti akademik 2017-1018 nuk ka përfunduar ende.

Grupet e vlerësimit të Brendshëm të cilësisë janë përgjegjës për procesin e vetvlerësimit dhe implementimit të planveprimit për sigurimin e cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike, UMSH është ngritur me Urdhër të Rektorit; Nr. 7 datë 01.03.2018. Sipas këtij urdhri janë ngritur GVB ad hoc.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Vlerësim për stafin, formular i vlerësimit të pedagogëve, relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Gjatë vizitës në institucion, në bisedë me anëtarët e NJSBC, na u pohua se për sigurimin e cilësisë institucioni përdor metoda vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese në mënyrë periodike për ecurinë e programeve të studimeve. Institucioni nëpërmjet NJSBCZHK harton një raport vjetor, ku përfshihen të gjitha metodologjitë dhe instrumentet vlerësuese të përdorura. NJSBCZHK në mënyrë periodike raporton dhe informon organet drejtuese në lidhje me rezultatet e kontrolleve të zhvilluara. Rezultatet e kontrolleve të zhvilluara bëhen publike për të gjithë drejtuesit e institucionit. Ky raport me rezultatet përkatëse ju vihet në dispozicion gjithë stafit në mënyrë konfidenciale (drejtpërdrejtë për secilin jo në përgjithësi). Rezultatet e vlerësimit të pedagogëve reflektohen në vlerësimin e performancës së tyre në përfundim të vitit akademik. Për vlerësimin e cilësisë Institucioni përdor metodat
<b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
<b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:	
Të tërthorta: a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj.	

<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>e tërthorta si:</p> <p>Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve.</p> <p>Studentët aktualë anketohen dy herë në vit përpara sezonit të provimit. Ata pyeten për korrektesën e pedagogut, mënyrën e shpjegimit të koncepteve, teknologjinë e përdorur, etj..</p> <p>Për vlerësimin e cilësisë Institucioni përdor metodat e drejtpërdrejta si:</p> <p>Dëgjime në auditor, ku profesorët, përgjegjësit e departamenteve asistojnë pedagogët gjatë orëve të mësimi.</p> <p>Gjithashtu cdo vit kontrollohen vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët për të kuptuar nivelin e ecurisë së tyre.</p> <p>Pedagogët udhëheqës, vëzhgojnë dhe kontrollojnë studentët gjatë kryerjes së praktikës profesionale.</p>
--	--

### VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

#### Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka dorëzuar materialet e nevojshme për të treguar që ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është akredituar institucionalisht në vitin 2012.</p> <p>Aktualisht funksionon si universitet në bazë të Urdhrit nr. 278 dt 19.05.2017 të MASH.</p> <p>Pranë Institucionit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave.</p> <p>Institucioni ka të hartuar në mënyrë të qartë politikën e procedurës së vlerësimit periodik. NJSBCZHK zhvillon aktivitetin e saj nëpërmjet një plani kalendar të përvitshëm. Ky plan veprim është në përputhje me strategjinë e miratuar nga Senati. Ky plan mbikëqyret, koordinohet dhe implementohet nga NJSBC. Aktiviteti i NJSBC bazohet në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Në mënyrë periodike raportet e hartuara nga NJSBCZHK analizohen dhe vendoset planveprimi në vijim për rritje të cilësisë së brendshme. Institucioni nëpërmjet raportit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, nëpërmjet anketave me studentët, nëpërmjet asistimit në auditorë ndërgjegjëson si stafi akademik ashtu edhe studentët në lidhje me rëndësinë e rritjes së cilësisë. Si stafi ashtu edhe studentët njihen me kërkesat mbi</p>
---	---

cilësinë e universitetit në fillim të vitit akademik dhe gjatë vitit në takime me drejtuesit e institucionit. Institucioni ka të hartuar Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Bsc në Shkenca Ekonomike, Rregulloren e brendshme e NJSBCZHK dhe Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të publikuara dhe japin një panoramë të strategjisë së përgjithshme të institucionit në lidhje me rritjen e cilësisë.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” i jep rëndësi sigurimit të brendshëm të cilësisë . Pjesë e strukturës së institucionit është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave.
2. Institucioni ka të hartuar në mënyrë të qartë politikën e procedurës së vlerësimit periodik. NJSBCZHK është organi kryesor që realizon anketimet për matjen e performancës së pedagogëve në procesin e mësimor, për vlerësimin e infrastrukturës mësimore, për vlerësimin e punës me studentët dhe të sekretarisë mësimore.
3. Për vlerësimin e cilësisë Institucioni përdor metodën e tërthortë të anketimit të studentëve dhe metodën e drejtpërdrejtë të dëgjimit në auditor të pedagogëve, etj..
4. Në mënyrë periodike raportet e hartuara nga NJSBCZHK raportohen në organet drejtuese, analizohen dhe vendoset për planveprim të mëtejshëm për cdo rritje të cilësisë së brendshme të nevojshme.

**Standardet përmbushen plotësisht**

### **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

#### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

#### **Pjesa përshkrimore**

Misioni i këtij programi studimi është ti pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e biznesit, të operacioneve financiare dhe të detyrimeve ekonomike me kushtëzim juridik. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e menaxhimit dhe të marketingut, financës dhe kontabilitetit, të legjislacionit të së drejtës civile, të së drejtës së punës, ndërtimit të kontratave të punës, etj.. Programi i studimit ka synim kompletimin e studentit me njohuri bazë dhe speciale në fushën e ekonomisë.

Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve për sektorin privat, publik dhe organizatat jofitimprurëse. Objektivi i programit të studimit është formimi teorik dhe praktik i studentëve.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike (me profile) është program studimi me kohë të plotë, me kohëgjatje 3 vite dhe me ndarje në 6 (gjashtë) semestra, me 180 ECTS kredite në total, ora mësimore zgjat 50 minuta.

Format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore, provimet, etj

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile i zhvilluar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, ka filluar në vitin 2009. Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave nr.124, datë 29.03.2011, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile, është akredituar për herë të parë.

Objektivi i programit të studimit është formimi i specialistëve të aftë në fushat e ekonomisë si në sektorin privat ashtu edhe publik, në pozicione si menaxher finance, kontabiliteti, menaxher marketingu, menaxher shitjesh, prokurimesh, etj.

#### **Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

- 1 vit akademik ka     \_\_30\_\_ javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka         \_\_15\_\_ javë mësimore në auditor

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile zhvillohet në 3 (tre) vite akademike, dhe 6 semestra gjithsej për cdo profil.

Cdo vit akademik ka 2(dy) semestra me nga 15 javë mësimore në auditor secili, zhvillohen 30 javë mësimore në auditor gjithsej në një vit akademik.

Gjatë 15 javëve të mësimt, ky i fundit realizohet kryesisht me leksione dhe seminare. Në disa lëndë specifike të profesionit si lëndët e kontabilitetit, financës dhe informatikës, programi ka kredite të vecanta për zhvillimin e laboratorëve.

Në fund të vitit të tretë të studimit studenti kryen praktikë profesionale, të zhvilluar pranë bizneseve, institucioneve, etj. me të cilët Universiteti “Mesdhetar” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në fund të tre viteve të studimit studenti kryen provimin e formimit.

#### **Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Në Aneksin 4, Tabela 9 jepet Plani mësimor i vitit 2017-2018. Plani mësimor nuk ka ndryshuar në vite në mënyrë thelbësore me shtim apo pakësim lënde, për këtë arsye është dhënë vetëm i vitit 2017-2018 dhe në Tabelën 10, Aneksi 5 janë dhënë ndryshimet të cilat janë ndryshim semestri ose

emërtimi lënde. Plani mësimor i vitit 2017-2018 është pothuaj i njëjtë me planin mësimor të licensuar. Tabela 11 jep planin mësimor të lidhur me stafin akademik.

**☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profil Financë, Bankë dhe Kontabilitet:**

Në cdo vit akademik realizohen 1500 orë në auditorë dhe punë të pavarura sipas ndarjes së paraqitur në vijim. Një vit akademik ka 60 kredite (ECTS). Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profil Financë, Bankë dhe Kontabilitet ka gjithsej 180 kredite (ECTS).

- |                              |                         |                                     |
|------------------------------|-------------------------|-------------------------------------|
| ▪ Për leksionet              | 1110 orë në auditor dhe | 1310 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret              | 605 orë në auditor dhe  | 875 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Labororet              | 100 orë në auditor dhe  | 150 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 120 orë në auditor dhe  | 30 orë punë e pavarur e studentit   |
| ▪ Provimi përfundimtar       | 20 orë në auditor dhe   | 180 orë punë e pavarur e studentit  |

Gjithsej 1955 orë në auditor, 78.2 kredite (ECTS) dhe 2545 orë punë e pavarur e studentit, 101.8 kredite (ECTS). Gjithsej 4500 orë dhe 180 kredite (ECTS).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profil Administrim Biznesi:

- |                              |                         |                                     |
|------------------------------|-------------------------|-------------------------------------|
| ▪ Për leksionet              | 1110 orë në auditor dhe | 1310 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret              | 615 orë në auditor dhe  | 890 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Labororet              | 90 orë në auditor dhe   | 135 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 120 orë në auditor dhe  | 30 orë punë e pavarur e studentit   |
| ▪ Provimi përfundimtar       | 20 orë në auditor dhe   | 180 orë punë e pavarur e studentit  |

Gjithsej 1955 orë në auditor, 78.2 kredite (ECTS) dhe 2545 orë punë e pavarur e studentit, 101.8 kredite (ECTS). Gjithsej 4500 orë dhe 180 kredite (ECTS).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profil Biznes dhe Ligj:

- |                              |                         |                                     |
|------------------------------|-------------------------|-------------------------------------|
| ▪ Për leksionet              | 1110 orë në auditor dhe | 1310 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret              | 615 orë në auditor dhe  | 890 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Labororet              | 90 orë në auditor dhe   | 135 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 120 orë në auditor dhe  | 30 orë punë e pavarur e studentit   |
| ▪ Provimi përfundimtar       | 20 orë në auditor dhe   | 180 orë punë e pavarur e studentit  |

Gjithsej 1955 orë në auditor, 78.2 kredite (ECTS) dhe 2545 orë punë e pavarur e studentit, 101.8 kredite (ECTS). Gjithsej 4500 orë dhe 180 kredite (ECTS).

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 10, Aneksi 5)**

Plani mësimor i vitit 2017-2018 është pothuaj i njëjtë me planin mësimor të licensuar sepse ka vetëm 3 (tre) ndryshime.

*Ndryshimi 1 është ndryshim semestri me njëri-tjetrin të lëndëve Statistikë me Menaxhimi i burimeve njerëzore. Është ndryshuar viti i zhvillimit i lëndës Statistikë nga viti i tretë në të dytë dhe i Menaxhimit të burimeve njerëzore nga viti i dytë në të tretë.*

*Ndryshimi 2 është ndryshim emërtimi i lëndës Ekonomia e burimeve njerëzore në Menaxhim i burimeve njerëzore dhe kalimi nga vitit i dytë në vitin e tretë në semestrin e parë, sic është shpjeguar edhe tek ndryshimi 1.*

*Ndryshimi 3 është shtrirja e lëndës Drejtim Financiar në të dy semestrat e vitit të tretë, nga vetëm në semestrin e parë të vitit të tretë që ishte në planin e licensuar.*

Plani mësimor i vitit 2017-2018 nuk ka ndryshime në shtim apo pakësim Lënde me planin mësimor të licensuar.

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Tabela 11, Aneksi 6 jep të dhëna për personelin akademik të lidhur me planet mësimore. Ajo që vihet re nga të dhënat e personelit akademik që lidhen me planet mësimore sipas RVB, është fakti që në cdo lëndë të paktën një pedagog ka gradën Dr, Prof.Asoc. apo Prof. Dr. Përrjashtim bënë vetëm Gjuha e huaj ku pedagogët janë me Msc. Kualifikimi i pedagogëve me grada dhe tituj shkencor tregon edhe nivelin e mësimdhënies që ata ofrojnë si dhe përgatitjen shkencore të tyre.

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

Syllabuset e lëndëve janë të plota. Në to paraqitet pedagogu/pedagogët që zhvillojnë mësimin, viti që do të zhvillohet si dhe kreditet e fituara prej lëndës. Lëndët nuk kanë të përcaktuar nevojë apo kusht për njohuri paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës apo lëndë që duhet ti ketë të fituara për të ndjekur një lëndë tjetër. Në syllabuse jepen temat që do të zhvillohen. Në përgjithësi lëndët vlerësojnë studentët me pikë për aktivizimin dhe frekuentimin në nivelin 10% të vlerësimit, Provim i ndërmjetëm (ose/edhe ese apo punim kursi) 20% të vlerësimit dhe provim përfundimtar 70% të vlerësimit.

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Lëndët që zhvillohen janë të ndara në dy grupe:

— Lëndë të detyrueshme

— Lëndë me zgjedhje. Zgjedhja e lëndëve bëhet gjatë dy javëve të para të semestrit.

Në përgjithësi syllabuset janë të plota. Në disa syllabuse mungon viti i botimit të tekstit bazë apo mënyra e vlerësimit në totalin e vlerësimit, si për shembull në lëndën Njohuri mbi Trashëgiminë Kulture dhe Natyrore mes Shqipërisë dhe Vendeve të Mesdheut, tek Literatura e detyrueshme teksti bazë nuk ka vit publikimi. Në këtë lëndë nuk është dhënë pesha e secilës mënyrë vlerësimi në totalin e vlerësimit. Në lëndën Tregjet dhe Institucionet financiare, E drejta administrative dhe e punës, nuk është dhënë pesha e secilës mënyrë vlerësimi në totalin e vlerësimit, etj.

Pasi u analizuan Syllabuset konkludojmë se si Fakultet i Shkencave Ekonomike lëndët e ofruara i japin mundësinë studentëve të formohen profesionalisht si me koncepte bazë ashtu edhe me koncepte të specialiteteve të ndryshme që ata mund të punojnë pas diplomimit. Megjithatë, në Profilin Financë, Bankë dhe Kontabilitet si dhe në Profilin Administrim Biznesi, vecanërisht në profilin Financë, Bankë dhe Kontabilitet mendojmë se mund të kishte lëndë specifike finance si lëndë mbi fiskalitetet, sigurimet, financat personale, etj., të cilët do të kompletinin njohuritë e studentëve në fushën e financës. Gjatë vizitës u pyet stafi akademik në lidhje me Fiskalitetet dhe Sigurimet dhe përgjigjja e tyre ishte se këto koncepte janë përfshirë në lëndë të tjera gjë që nuk rezulton nga syllabuset.

Në vitin e II dhe të III të programit të studimit me profile, kreditet (ECTS) janë të njëjta pavarësisht kujt Tipi veprimtarie i përket lënda. Kështu për shembull Lënda Drejtim Financiar e cila është e shtrirë në dy semestra dhe është lëndë karakterizuese ka të njëjtat kredite sa Gjuha e huaj dhe lëndët që zhvillohen në një semestër. Nëse do të rishikoheshin kreditet do të kishte mundësi edhe të shtimit të ndonjë lëndë tjetër financiare, vecanërisht në vit të tretë ku zhvillohen vetëm 6 lëndë në total për të 2 semestrat.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve. Me urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave nr.124, datë 29.03.2011, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile, është akredituar për herë të parë.
<b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Orët që zhvillohen si në auditorë dhe në mënyrë të pavarur vlerësohen me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në cdo vit akademik realizohen 1500 orë në auditorë



	<p>dhe punë të pavarura sipas ndarjes së paraqitur në vijim, një vit kalendarik ka 60 kredite (ECTS). Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profil Financë, Bankë dhe Kontabilitet ka gjithsej 180 kredite (ECTS).</p>
<p align="center"><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Njësitë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile, japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me Planin mësimor për të tre vitet akademike të Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile, për cdo profil, të gjithë të interesuarve. Infomacioni në lidhje me programin e studimit ju jepet studentëve që në momentin e fillimit të studimit.</p> <p>Në planin mësimor janë specifikuar lëndët e detyrueshme dhe lëndët me zgjedhje.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve jepet informacion mbi orët në auditor, orët e leksioneve, të seminareve, të laboratorëve nëse ka. Gjithashtu përcaktohen kriteret e frekuentimit të lëndëve në përputhje me rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Studentët njihen edhe me detyrimin e zhvillimit të praktikës në përfundim të studimeve si dhe përfitimin profesional që ata kanë prej saj.</p> <p>Ky informacion ju ofrohet studentëve potencial (gjimnazistëve) gjatë takimeve me ta.</p> <p>Aplikantët që kërkojnë të ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkencat Ekonomike me profile ju ofrohet dokumentacioni i nevojshëm si: rregullorja, plani mësimor, kriteret për pranimin e studentëve, etj.</p> <p>Institucioni përdor rrjetet sociale dhe faqen e vet zyrtare për të ofruar informacionin.</p> <p>Studentët gjatë takimit me ta na shpjeguan se njiheshin me elementët e syllabusit në fillim të cdo lëndë në mënyrë të detajuar.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile, është i akredituar. Orët që zhvillohen vlerësohen me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</li> <li>2. Programi i studimit ofron lëndë që zhvillojnë formimin e përgjithshëm dhe lënë që rrisin aftësitë profesionale. Në planin mësimor janë të specifikuara lëndët e detyrueshme dhe lëndët me zgjedhje.</li> <li>3. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion mbi orët në auditor, orët e leksioneve, të seminareve, të laboratorëve nëse ka.</li> <li>4. Të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me përmbajtjen e programeve të studimeve, lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin, praktikën, etj. janë disponibël për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</li> </ol>	
<p><b>Standarded përmbushen plotësisht</b></p>	



## 8. Mësimdhënia

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

### Pjesa përshkimore

Mësimdhënia është një aspekt i rëndësishëm për një program studimi, sepse format e mësimdhënies përcaktojnë edhe nxënien dhe cilësinë e mësimdhënies. Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët dhe laboratorët në lëndët ku ato zhvillohen. Në rregulloren e programit të studimit jepen format kryesore të punës mësimore si leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore, laboratorët, detyrat, projektet dhe provimet.

Leksionet zhvillohen në bazë kursi deri në 6 grupe. Seminarët me grupe deri në 35 studentë. Në standartin e mëparshëm kemi paraqitur orët në auditor dhe orët që punojnë studentët në mënyrë të pavarur me detajimet përkatëse. Sic vihet re dominojnë leksionet me rreth 57% të ngarkesës në auditor. Rreth 31% e ngarkesës e zënë seminarët ku studenti ushtron dijet e tij me anë të ushtrimeve dhe rasteve studimore. Laboratorët zënë rreth 5 % të ngarkesës në auditore, praktika profesionale rreth 6% dhe diplomimi rreth 1 %.

Leksionet në shumë lëndë janë sa dyfishi i seminarëve ku është pedagogu ai që shpjegon dhe analizon tematikat përkatëse, ndoshta mund të shihet si mundësi një balancim orësh leksione dhe seminarë për të mos lodhur studentët me shumë orë leksioni në të njëjtën lëndë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Llojet e Formave të mësimdhënies (ndarja e orëve në auditor) për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me profile Financë, Bankë dhe Kontabilitet, me profil Administrim Biznesi dhe me profil Biznes dhe Ligj janë të detajuara si më poshtë:

- |                 |                     |
|-----------------|---------------------|
| ▪ Për leksionet | 1110 orë në auditor |
| ▪ Për Seminarët | 615 orë në auditor  |

- Për Laboratoret 90 orë në auditor
- Për Praktikën Profesionale 120 orë në auditor
- Provimi përfundimtar (Diplomimi) 20 orë në auditor

**Format e kontrollit të njohurive**

Forma kryesore e kontrollit të dijes është provimi. Sipas rregullores mënyra të tjera të kontrollit të dijes mund të përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga njësia kryesore në programin e cdo lënde apo moduli. Në të gjithë syllabuset përcaktohet si formë e kontrollit të njohurive provimi përfundimtar. Në syllabuse përcaktohen edhe pikë vlerësimi nga aktivizimi dhe frekuentimi në seminar si dhe për detyra apo projekte kursi si dhe për provim të ndërmjetëm. Nga syllabuset mund të themi se provimi i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar zënë rreth 70-80 % të vlerësimit të kontrollit të njohurive.

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Sipas RVB numri i studentëve të aktivizuar në projekte shkencore në rang fakulteti është 46. Gjatë takimit stafi akademik na tha se studentët përfshihen edhe në konferencën që zhvillon fakulteti por në një numër relativisht të kufizuar të tyre. Megjithatë studentët ishin pjesëmarrës aktiv në Panairin e Ideve.

**9. Studentët**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

**Pjesa përshkimore**

Procedurat e pranimit të studentëve bazohen në rregulloren e institucionit dhe bazë është cdo përcaktim ligjor i kriterëve të pranimit. Nga të dhënat e ofruara nga institucioni vihet re një rritje e qëndrueshme e numrit të studentëve të cilët ndjekin këtë universitet dhe në vecanti programi Bsc ka pasur një rritje të dukshme në numër studentësh si ata që janë regjistruar për herë të parë ashtu dhe studentë të transferuar në vitet e ndërmjetme. Një gjë e tillë tregon se imazhi i institucionit është pozitiv dhe pritshmëria e studentëve prej tij është e lartë.

**Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

**Procedurat e pranimit të studentëve**

Procedura e pranimit të studentëve jepet në rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Shkenca ekonomike me profile, neni 11-14. Sipas vendimit të Universitetit Mesdhetar Nr.2/1, datë

07.02. 2018 për përcaktimin e kriterit të pranimit të studentëve Universiteti Mesdhetar bazohet në Ligjin 80/15 “Per arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për ciklin e parë kriteri bazë për pranimet për vitin 2018-2019, është nota mesatare minimale përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave për këtë vit akademik. Departamenti përgjegjës për organizimin e programit të studimit të ciklit të parë bënë renditjen e studentëve në bazë të notës mesatare dhe pranon studentët me mesatare më të lartë deri në nivelin e kuotave të pranimit. Sipas rregullores kandidatët duhet të paraqesin Deftesen e Maturës Shtetërore , listën e notave, ID (në fotokopje të noteruar), si dhe cdo dokument tjetër sipas dispozitave ligjore në fuqi në kohën e aplikimit.

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**


Sipas dokumentacionit të marrë nga institucioni nga viti akademik 2012-2013 deri në vitin akademik 2017-2018, nota mesatare e studentëve në hyrje në ciklin e parë të studimit ka variuar nga 6.62 deri në 7.74. përsa i përket nivelit mesatar të notave gjithsej gjatë studimeve, të cilësuar si nota në dalje, niveli është i krahasueshëm me atë në hyrje me një ulje të lehtë, nota mesatare ka variuar nga 5.76 deri në 6.93.

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Studentë të transferuar sipas viteve (b)			Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)
		Viti I	Viti II	Viti III		
2011-2012	Nuk ka te dhena nga Institucioni					
2012-2013	55	0	14	64	78	133
2013-2014	62	1	6	32	39	101
2014-2015	133	9	76	267	352	485
2015-2016	262	181	35	170	386	648
2016-2017	188	199	39	141	379	567
2017-2018	174	311	69	202	582	756

**Burimi: Të dhënat janë marrë nga regjistrat gjatë vizitës në institucion**

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare ne hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)			Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III		
2012-2013	55	7.74	0	14	64	78	133



2013-2014	62	7.32	1	6	32	39	101
2014-2015	133	6.86	9	76	267	352	485
2015-2016	260	6.62	1	35	170	206	466
2016-2017	186	6.94	46	39	141	226	412
2017-2018	176	7.31	48	69	202	319	495

**Burimi: RVB**

Tabela jep Studentët e rregjistruar për herë të parë në vitin e parë si dhe transferimet. Shifrat e dhena për studentët e rregjistruar për herë të parë në vitin e parë nuk janë të njëjta me ato të paraqitura në RVB.

Diferenca të mëdha gjejmë në numrin e studentëve të transferuar në vitin e parë të viteve 2015-2016, 2016-2017 dhe 2017-2018, nga verifikimi i rregjistrave. Në tabelën vijuese kemi paraqitur për ato vite shifrat e marra nga rregjistrat. Gjatë verifikimit të rregjistrave u vunë re shumë studentë pa numra matriculimi, vecanërisht tek studentët e transferuar konkretisht:

Për vitin 2015 – 2016 për dy profile 78 studentë

Për vitin 2016 – 2017 për tre profile 147 studentë

Për vitin 2017 – 2018 për dy profile 123 studentë

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Viti akademik 2017-2018 është në proces ndaj nuk ka të dhëna për diplomime. Viti i fundit i të diplomuarve është viti 2016-2017.

Në vitin akademik 2016-2017 të diplomuarit në nivelin Bachelor në Ekonomi, me profile janë si më poshtë:

Në profilin Financë, Bankë dhe Kontabilitet janë diplomuar 70 studentë me notë mesatare 6.73.

Në profilin Administrim Biznesi janë diplomuar 163 studentë me notë mesatare 6.22.

Në profilin Biznes dhe Ligj janë diplomuar 15 studentë me notë mesatare 5.97.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Universiteti Mesdhetar ka një procedurë të qartë të transferimit të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend. Procedura e transferimit bazohet në Udhëzimet që nxjerr MASH në vitin akademik përkatës, në udhëzimet që nxjerr vet UMSH dhe në Statutin dhe rregulloren e UMSH. Sipas procedurës studentët bëjnë kërkesë pranë dekanatit dhe ky i fundit merr vendimin e transferimit bazuar në Udhëzimet dhe rregullat e përmendura më sipër.

Nga të dhënat që disponojmë nga institucioni shihet që institucioni ka studentë të transferuar pranë tij nga universitet e tjera brenda vendit, e verifikuar edhe nga rregjistrat në vizitën në institucion.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Institucioni ka të dhëna mbi punësimin e studentëve. Në vizitën në institucion na u tha se meqë numri i studentëve nuk ishte shumë i lartë kontaktet me ta në pjesën më të madhe mbaheshin edhe në mënyrë joformale dhe kishin dijeni se ku ata punonin. Në të njëjtën kohë institucioni mbante kontakte nepermjet email apo nr të telefonit me studentët e diplomuar.

**Numri total të diplomuarve**

Sipas Tabeles së dhënë nga institucioni si dhe gjatë vizitës rezulton se janë 1013 të diplomuar në Bsc në Shkenca ekonomike me profile. Në takim na u komunikua se një pjesë e tyre vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve pranë UMSH. Ndersa një pjesë tjetër janë dilomuar dhe janë në marrëdhënie pune apo vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve pranë universiteteve të tjera në vend.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Sipas RVB numri i të diplomuarve në Bachelor në Shkenca Ekonomike me profile, dhe që nuk vazhdojnë studime të ciklit të dytë pranë UMSH janë 558 studentë. Nga këta 399 të diplomuar janë të punësuar në përputhje me diplomën.

Sipas RVB 85 të diplomuar janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Të dhëna mbi të regjistruarit dhe të diplomuarit.

Përmbledhje e procedurës së transferimit.

Kriteret e pranimit të studentëve 2018-2019 UMSH.

Udhezim praktikat

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Institucioni jep kriteret e pranimit të studentëve cdo vit me propozim të departamenteve përkatëse. Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me kërkesat e departamentit. Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë merr vendim në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve ku kriteri kryesor është nota mesatare minimale
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	

	<p>përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave për cdo vit akademik.</p> <p>Gjithashtu UMSH merr parasysh edhe mundësinë e vendosjes së kriterëve shtesë për pranimin e studentëve ne bazë të statutit dhe rregullores.</p>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve. Studentët informohen për të gjitha këto që në momentin e aplikimit për ndjekjen e studimeve pranë UMSH. Institucioni organizon takime me gjimnazistë ku ofron informacione të programit të studimit edhe me aplikantët potencial.</p> <p>Në përfundim të cdo semestri studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde me anë të një pyetësori që ju jepet për tu plotësuar nga departamenti përgjegjës.</p> <p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës.</p> <p>Në UMSH përvec zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët për të cilët ai është tutori.</p> <p>Një pedagog është tutori i dy grupeve mësimore me studentë.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, për numrin e të transferuarve drejt institucionit nga Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit.</p> <p>Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p> <p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në ciklin e parë, për mesataren me të cilën janë pranuar, dhe për mesataren me të cilën janë diplomuar pranë UMSH.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve</p>

në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës.

Tutorët e përcaktuar të studentëve ndjekin ecurinë e studentëve dhe të gjitha çështjet apo problematikat që kanë të bëjnë me procesin mësimor.

Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.

Për kryerjen e praktikave institucioni ka lidhur një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo biznese të ndryshme.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga UMSH, cdo pedagog mbikëqyr 12 studentë në praktikë.

Për zhvillimin e praktikave UMSH organizon edhe internshipe.

Studenti dorëzon dosjen e praktikës në bazë të rregullores së praktikës. Për Praktikën profesionale studentit vlerësohet me notë.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve.
2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, për numrin e të transferuarve drejt institucionit nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit.
3. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës. Në UMSH përveç zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët.
4. Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.

**Standardet përmbushen plotësisht**

### **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

#### **10. Kërkimi shkencor**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

#### **Pjesa përshkrimore**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ngritur në përbërje të njësisive kryesore edhe Qendrën e Kërkimit Shkencor e cila mbikëqyr kërkimin shkencor të stafit dhe studentëve. Gjithashtu është ngritur për këtë qëllim edhe zyra e projekteve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ takoi përfaqësuesit e kësaj zyre. Politika e kërkimit shkencor në këtë program studimi duket shumë kërkuese. Kërkimi shkencor si një faktor shumë i rëndësishëm për institucionet e arsimit të lartë është institucionalizuar jo vetëm me hapjen e zyrës së kërkimit shkencor por edhe me pozicionin e një



zv. Rektori për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e kërkimit shkencor. Politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi konsistojnë në rritjen e nivelit shkencor të pedagogëve, nëpërmjet botimeve në revista shkencore, pjesëmarrje në konferenca, nxitje të marrjes së gradës Phd në universitete të huaja. Cdo fundviti institucioni pasi bën vlerësimin e performancë së stafit nxjerr edhe detyrat e ardhshme në lidhje me kualifikimet dhe kërkimin shkencor të secilit.

Institucioni mbështet financiarisht stafin për avancimin e karrierës së tyre dhe specifkisht në drejtim të kërkimit shkencor duke paguar tarifat e botimeve apo publikimit si dhe shpenzime të tjera mbështetëse. Institucioni mbështet edhe botime librash dhe monografish me kërkesë të pedagogëve.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë boton revistën shkencore me Bord Editorial EUROMEDITERRANEAN ku pedagogët kanë mundësi të ballafaqojnë mendimet e tyre shkencore. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë organizon cdo vit Konferencë Ndërkombëtare Shkencore. Në Konferencën Shkencore ftohen të marrin pjesë edhe studentët. Studentët marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetin shkencor të studentëve Panairin e Ideve që organizon UMSH cdo vit. Po në funksion të ndjekjes së politikës së kërkimit shkencor institucioni ka lidhur shumë marrëveshje bashkëpunimi me organizma qeveritarë, institucione vendase dhe të huaja si dhe aplikon për të qenë pjesëmarrës në projekte të ndryshme.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Të dhëna për kërkimin shkencor**

Në dokumentacionin e derguar nga institucioni UMSH janë CV e pedagogëve, në përbërje të të cilave duket një aktivitet shkencor i bollshëm dhe cilësor. Pedagogët kanë marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm konferencash dhe kanë publikime në revista të ndryshme shkencore. Gjithashtu disa nga pedagogët janë edhe autorë librash universitar.

##### **Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL**

Sipas RVB numri gjithsej i botimeve nga personeli akademik efektiv i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është 949. (Tabela 12)

##### **Numri i projekteve kërkimore të fituara**

Sipas të dhënave nga informacioni i dhënë nga UMSH dhe nga RVB janë 3 projekte të fituara, njëri ka përfunduar ndërsa dy janë në proces.

##### **Numri i projekteve të zbatuara**

Sipas të dhënave nga informacioni i dhënë nga UMSH dhe nga RVB janë 3 projekte të fituara dhe të zbatuara. Dy nga projektet janë pjesë e programit Erasmus +, njëri është në vijim ndërsa tjetri ka përfunduar. Projekti i tretë që është në vijim është pjesë e EU Programme: European Cooperation for Science and Technology.

**Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga UMSH janë 7, sipas RVB. Sic është përmendur më sipër Institucioni organizon Konferencë Ndërkombatërore Shkencore dhe Panairin e Ideve.

**Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL**

Në aktivitet e sipërpërmendura shkencore numri i pjesëmarrësve ka qenë 532 sipas RVB.

**Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor**

Sipas RVB numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor ka qenë 3.

**Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor**

Sipas RVB numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor ka qenë 174. Gjatë vizitës në institucion u theksua nga stafi se studentët inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete shkencore. Studentët përfshihen pak në Konferencën Shkencore por marrin pjesë aktivisht në Panairin e Ideve. Në Panairin e Ideve studentët marrin pjesë me punime të ndryshme sepse ideja është paraqitja e sa më shumë ideve të reja në lidhje me ekonominë në përgjithësi dhe çështje specifike të saj në vecanti.

**Numri i Çmimeve Kombëtare**

Sipas RVB janë fituar 2 cmime kombëtare. Nuk ka një dokument që të vërtetojë marrjen e këtyre cmimeve.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Panairi i Ideve 2016-2017.

11. **Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**  
**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Pranë Institucionit është ngritur Zyra e projekteve. Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Zyra e projekteve merret me aplikime në projekte të mundshme, dhe ndjek zbatimin e tyre. Këto dy zyra në bashkëpunim, si dhe drejtuesit e institucionit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, dhomën e tregtisë, biznese të ndryshme, me universitete brenda dhe jashtë vendit. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është pjesë e programit ERASMUS. Në RVB theksohet se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë vlerëson të rëndësishme vecanërisht marrëveshjet me universitete të huaja, me qëllim shkencor si pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe përafrim të kurrikulave. Institucioni në dokumentacion ka dhënë një kopje të marrëveshjeve me të gjitha specifikat e tyre. Në to përcaktohet qartë qëllimi, parimet e bashkëpunimit si dhe kushtet e bashkëpunimit sipas kërkesave të bashkëpunimeve.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar**

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare, sipas RVB është 23 por në shumicën e projekteve është ende në fazë aplikimi. Në pasqyrën e të ardhurave nuk pasqyrohet asnjë zë që vjen nga projektet. Institucioni ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme leksione me lektorë vendas dhe të huaj si dhe tryeza të rrumbullakëta diskutimesh.

Leksionet që janë zhvilluar kanë qenë pjesë e bashkëpunimeve kombëtare ose ndërkombëtare ose lektorët kanë qenë të ftuar nga Institucioni për të zhvilluar leksione në tematika të ndryshme. Sipas RVB, leksionet me lektorë të huaj kanë qenë 108 orë mësimore.

Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit sipas RVB janë 8. Institucioni mbështet kërkimin shkencor jashtë vendit duke mundësuar dhe financuar aktivitetet akademike jashtë vendit. Institucioni ofron mbështetje për mobilitete të stafit akademik dhe për mobilitete të studentëve si dhe për studime në ciklin e tretë të studimeve jashtë. Sipas RVB 3 studentë të UMSH kanë përfituar nga projekte Erasmus+.

Në ambjentet e UMSH ndodhet edhe biblioteka me libra të fushave të ndryshme në funksion të programeve që ofron institucioni. Biblioteka është abonuar në QUESTA online duke ofruar kështu mundësinë e titujve të shumtë nëpërmjet bibliotekës online. Institucioni ka salla konferencash të cilat perdoren për aktivitete shkencore.

Sipas RVB numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime është 47.

#### **Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:**

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese



- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione qeveritare. Kështu, është lidhur marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me synim hulumtime të përbashkëta, etj. UMSH ka lidhur marrëveshje me INSTAT për angazhimin e studentëve në kryerjen e praktikave profesionale atje si dhe për veprimtari të kërkimit shkencor të përbashkët. (Tabela 13)

Gjithashtu janë lidhur marrëveshje me institucione të tjera si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, disa bashki etj.

Institucioni ka lidhur marrëveshje edhe me Organizata Profesionale kryesisht të huaja dhe Universitete. Në bazë të këtyre marrëveshjeve institucioni synon shkëmbim stafi, dhe studentësh. Këto marrëveshje kanë si qëllim edhe shkëmbimi i literaturës, apo nxitja e sipërmarrjeve të përbashkëta. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me Komunitetin e biznesit, tregun e punës. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është kualifikimi, kryerja e praktikave dhe punësimi i studentëve.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Informacion mbi aktivitetet e lidhura me marrëveshjet e bashkëpunimit. Lista e aktiviteteve me të ftuar në UMSH

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b> <b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik pohoi se institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të departamenteve. Bashkëpunimi ndërmjet personelit realizohet në diskutimet e kurrikulave. Informacioni qarkullon nëpërmjet strukturave përgjegjëse dhe diskutohet në mbledhjet e departamenteve për ruajtjen e vijimësisë së koncepteve mësimore të programit të studimit dhe shmangien e përsëritjeve.</p> <p>Institucioni ka vendosur kriteret e vlerësimit të stafit ku përfshihen edhe pjesëmarrjet në aktivitete shkencore duke nxitur kështu bashkëpunimet ndërmjet stafit në drejtim të karrierës. Sipas RVB në UMSH secili pjesëtar i stafit ka detyra të përcaktuara dhe kjo garanton një fryme</p>



	bashkëpunimi shumë të mirë.
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka dorëzuar dokumentacionin e të gjitha marrëveshjeve të lidhura me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione qeveritare për mundësi zhvillimi praktikash studentore dhe hulumtime të përbashkëta.</p> <p>Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe, marrëveshje të cilat janë lidhur që në momentin e hapjes së programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione të huaja, universitete. Në bazë të këtyre marrëveshjeve institucioni synon shkëmbim stafi dhe studentësh.</p> <p>Institucioni ka lidhur marrëveshje me biznese të ndryshme të cilët ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale dhe për punësim.</p> <p>Institucioni ka hartuar një raport analitik për të gjitha marrëveshjet me qëllimet dhe përfitimet prej tyre.</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit.</li> <li>2. Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</li> <li>3. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, institucione qeveritare, biznese të ndryshme, me universitete brenda dhe jashtë vendit. Në themel të marrëveshjeve qëndron mundësia për zhvillim kërkimi shkencor, shkëmbim stafi dhe studentësh, zhvillimi praktikash studentore, hulumtime të përbashkëta dhe punësim të studentëve.</li> </ol>	
<b>Standarded përmbushen plotësisht</b>	

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Nga analiza e bërë në fillim të RVJ për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e pare, konkludojmë se institucioni ka bërë plotësim të pjesshëm të rekomandimeve, sepse:

	<b>Pikat përmbledhëse nga akreditimi i pare</b>	<b>Statusi aktual</b>
<b>A</b>	Të përfshihet në planin mësimor edhe një lëndë me zgjedhje për vitin e parë dhe të dytë, për profilet Financë, Bankë dhe kontabilitet; Administrim biznes.	<b>Nuk është plotësuar</b>
<b>B</b>	Të shikohet mundësia që për profilet: Financë, Bankë dhe Kontabilitet; Administrim biznesi, në vitin e tretë të studimeve, të shtohen disiplina sic janë “Kontrolli i brendshëm” dhe “Auditim në shërbimet e sigurisë”.	<b>Nuk është plotësuar</b>
<b>C</b>	Për profilin Biznes dhe ligj të shikohet mundësia për të zgjeruar disi më tej aspektin e trajtimit të ligjeve e rregullave duke përfshirë në mënyrë më të zgjeruar, çështjet e falimentimit, legjislacionin në funksionimin e entiteteve në industritë e rregulluara, me përfshirjen e këtyre tematikave në studimet e ciklit të dytë.	<b>Plotësuar</b>
